

AKT THEMELIMI

I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “DGS Group” Shpk

Në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjit Nr.9273 datë 03.07.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshur:
Sot, më datë 23.05.2023 une themeluesja kam krijuar, Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar “DGS Group” Shpk, me Ortak të vetëm shtetasen, Zj. Fationa Dervishi e datëlindjes 01.02.1990, lindur në Tiranë dhe banues në Lagjen Nr.3, Fetah Bllaca, Nd.3, H.2, Ap.10, Durrës, 2025, Durrës, shtetas shqiptar i identifikuar me ID, J05201085L, e cila do të funksionojë në bazë të këtij, **AKT-THEMELIMI**.

LLOJI DHE EMRI SHOQËRISË

NENI 1

Lloji i Shoqërisë Tregtare është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe emri i saj është “DGS Group” Shpk.

SELIA E SHOQËRISË

NENI 2

Zyra Qëndrore e Shoqërisë Tregtare “DGS Group” Shpk, e ka vendodhjen e saj në, Rr. “Fetah Bllaca, Nd.3, H.2, Ap.10, Durrës, 2025

REGJIMI JURIDIK

NENI 3

Shoqëria është shqiptare me përgjegjësi të kufizuar.
Shoqëria fiton personalitetin juridik në momentin që ajo regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

NENI 4

Objekt i aktivitetit të Shoqërisë Tregtare “DGS Group” Shpk është:

Shitjet online - drop shipping të produkteve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Import-eksport i mallrave të ndryshëm ushqimore dhe industriale si dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë i tyre.

KOHËZGJATJA

NENI 5

Shoqëria Tregtare “DGS Group” Shpk, do të kryej veprimtarinë dhe aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.

Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 6

Kapitali Themeltar i regjistruar i Shoqërisë Tregtare “DGS Group” Shpk, është në vlerën prej 100,000.00 (njëqind mijë) lekë.

Numri i kuotave (pjesëve) është 1(një)

Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e vetëm të:

Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortakët i vetëm themelues:

1. Zj. Fationa Dervishi: Zotëruese e 1(një) kuote, në vlerë para 100,000.00 (një qindë mijë) lekë dhe në përqindje (%) të përgjithshme përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

ADMINISTRIMI

NENI 7

Administrator i Shoqërisë i emëruar nga Asambleja e Ortakëve është Zj. Fationa Dervishi me një afat 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.

TË DREJTAT E SHOQËRISË

NENI 8

Shoqëria ka të drejtë të lidh kontrata dhe të nënshkruaj marrëveshje Brenda dhe jashtë vendit.

Shoqëria përgjigjet ndaj të treteve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur.

Shoqëria përballon humbjet vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributit të Kapitalit Themeltar.

VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

NENI 9

Viti financiar i shoqërise fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon me 31 Dhjetor.

SHPËRNDARJA E FITIMIT

NENI 10

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjane për rezervën sipas ligjit dhe nga ana tjetër janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Ky fitim shpërndahet midis Ortakëve të Shoqërisë sipas kontributit të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë.

LIKUJDIMI

NENI 11

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilën parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likujdatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën shtesë “shoqëri në likujdim e sipër”.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Ortakët.

Aktin e themelimit e lexuam dhe e gjetëm konform vullnetit tonë dhe e nënshkruajmë pa verejtje.

***ORTAKU I VETËM
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“DGS Group” Shpk***

Fationa Dervishi

